



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration*

RAPORT PËR “PLANIN E VEPRIMIT KOMUNAL PËR PVNMSA 2013”

2013

Prishtinë, Maj 2013

PËRMBAJTJA

- Hyrje
- Lista e komunave të cilat janë përgjigjur dhe nuk janë përgjigjur në këtë raport
- Kriteret politike
- Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve
- Aftësia për të përballuar obligimet që dalin nga MSA-ja
- Përmirësimi i Infrastrukturës në Zonat Rurale
- Shfrytëzimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve
- Kontrolli financiar
- Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

HYRJE

Ky raport është përpiluar në bazë të informatave të grumbulluara përmes të dhënave të komunave dhe kanë të bëjnë me obligimet e komunave të cila janë paraparë sipas Planit të Veprimit për Negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Për grumbullimin e informatave të këtij raporti kemi mbajtur dy takime me Zyrtarët komunal për Integritet Evropian. Takimi i parë është mbajtur më datë 22 shkurt i cili është financuar nga AKK, ndërsa Takimi i dytë është mbajtur më datë 13 mars 2013, i cili është financuar nga GIZ.

Megjithëse, ne me kohë kemi bërë përgatitjet paraprake si dhe kemi njoftuar dhe ftuar të gjitha ZKIE-të, përgjigjet janë dërguar vetëm nga 30 komuna, ndërsa 8 komuna të tjera nuk janë përgjigjur për Raportim të “Planit të veprimit komunal për PVNMSA 2013”.

LISTA E KOMUNAVE TË CILAT JANË PËRGJIGJUR DHE NUK JANË PËRGJIGJUR NË KËTË RAPORT

Komunat të cila janë përgjigjur në këtë raport, janë:

1. Deçani
2. Dragashi
3. Drenasi
4. Ferizaj
5. Fushë Kosova
6. Graçanica
7. Gjakova
8. Hani i Elezit
9. Istogu
10. Juniku
11. Lipjani
12. Kaçaniku
13. Kamenica
14. Klina
15. Malisheva
16. Mitrovica
17. Mitrovica Veriore
18. Novobërda
19. Obiliqi
20. Peja
21. Rahoveci
22. Podujeva
23. Prishtina
24. Prizreni
25. Skenderaj
26. Suharekë
27. Shtërpca
28. Shtime
29. Vitia
30. Vushtrria

Komunat të cila nuk janë përgjigjur, janë:


1. Ranillug
2. Kllokot
3. Partesh
4. Gjilan
5. Mamush
6. Zveçan
7. Zubin Potok
8. Leposaviç

1. KRITERET POLITIKE


Të forcohen kapacitetet e administratës në nivelin lokal, duke përfshirë komunat e sapo formuara, si dhe duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal.

1.1. A kanë ofruar ministritë udhëzime në ngritjen e kapaciteteve administrative në komunën tuaj ?


Sa i përket administratës dhe personelit, 18 prej komunave u janë përgjigjur pozitivisht pyetjes së parashtruar se Ministritë i kanë pajisur komunat me infrastrukturën ligjore dhe zbatimin e tyre është në nivelin e kënaqshëm për sa i përket udhëzimeve të nxjerra. Ndërsa, komuna e Klinës dhe Istogut ka thënë se nuk kanë marrë ndonjë udhëzim për këtë periudhë raportuese nga niveli qendror, si dhe udhëzimet të cilat i kanë marrë më herët si tërësi, nuk ka pasur zbatim të tërësishëm të tyre. Ndërkaq, komuna e Kamenicës është përgjigjur se janë duke punuar në këtë drejtim. Kurse, Komunat si: Gjakova, Skenderaj, Prishtina, Graçanica, Deçani, Rahoveci, Vitia, Drenasi nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje. Më poshtë janë pasqyruar të dhënat për komunat në formë tabelore:



Tab.1. Numri i Udhëzimeve dhe Rregulloreve të Komunave



Tab.2. Numri i Udhëzimeve dhe Rregulloreve të Komunave



Tab.3. Numri i Udhëzimeve dhe Rregulloreve të Komunave


1.2. Numri i udhëzimeve të ofruara nga Ministrinë për nivelin lokal janë këto:

1. U.A. 01/2011 për menaxhimin dhe përdorimin e Internetit në Institucionet e Republikës së Kosovës;
2. U.A. 03/2011, për Ueb faqet e Institucioneve Publike;
3. U.A. 02/2010 për menaxhimin e Sigurisë Informative;
4. U.A. 03/2010 për përdorimin e Softuerit dhe Harduer-it;
5. U.A. 04/2010 për shfrytëzimin e postës elektronike zyrtare;
6. U.A. 2011/03 për organizimin dhe funksionimin e qendrave të shërbimeve të qytetarëve në Komuna;
7. U.A. 2011/02 për përcaktimin e procedurave për zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve;
8. U.A. 2008/09 për transparencë në Komuna;
9. U.A. 2008/08 për marrëveshjet e bashkëpunimit të Komunave me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane;
10. U.A. 2007/08 për themelimin e njësive për të drejtat e njeriut në Komuna;
11. U.A. 2005/08 për përcaktimin e kompetencave dhe përshtetjen e detyrave të zyrtarit për barazi gjinore në Komuna;
12. Nr. 05/2012 - për klasifikimin e vendeve të punës për shërbyesit civil;
13. U/A Nr. 01/2013 - për dokumentet e gjendjes civile;
14. U/A Nr. 03/2013 - për vulën verifikuese;
15. U.A. Nr. 2011/03 për organizimin dhe funksionimin e qendrave për qytetarët në komuna;
16. U.A. Nr. 03/2011 për funksionimin e QSHQ.

1.3. Sa janë ngritur kapacitetet administrative në komunën tuaj ?

Në këtë drejtim, 20 prej komunave janë përgjigjur se ka pasur trajnime. Në bazë të trajnimeve dhe sistemit elektronik (teknologjisë informative), performanca komunale është në rritje e sipër dhe përpjekjet për thjeshtëzimin e procedurave administrative janë duke vazhduar, ku në dokumentacionin e lëshuar ka siguri. Komuna e Kaçanikut, Prizrenit, Lipjanit dhe Vitisë ka thënë se nuk kanë pasur trajnime të ofruara për periudhën janar - mars, por që po punojnë për shkurtimin dhe përsheptimin e procedurave administrative, ngritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së dokumenteve të lëshuara nga komuna. Ndërkaq, Komuna e Skenderajt, Prishtinës, Rahovecit, Graçanicës dhe Kamenicës nuk kanë dhënë asnjë përgjigje.

Sa i përket numrit të përgjithshëm të mbajtjes së trajnimeve, del të jetë se janë mbajtur gjithsej 120 trajnime, prej tyre janë trajnuar gjithsej 261 zyrtarë. Këto trajnime janë ofruar nga IKAP dhe Ministrinë, mirëpo për llojin e trajnimeve nuk është specifikuar nga asnjëra komunë, përveç Komunës së Mitrovicës Jugore që ka thënë se janë trajnuar zyrtarët komunal në lëmin e gjuhës angleze dhe programin ECDL.



Tab.4. Numri i mbajtjes së trajnimeve në komuna

1.4. Në çfarë faze është procesi i decentralizimit në Komunën e Mitrovicës së Veriut ?

Me qenë se ky veprim është specifik vetëm për Komunën e Mitrovicës së Veriut, komuna në fjalë i është përgjigjur Zyrës Administrative në Mitrovicën e Veriut e cila është themeluar me Vendim nr. 01/75, 23.05.2012. Sipas këtij Vendimi, ZAMV ofron të gjitha shërbimet për qytetarët e Mitrovicës së Veriut duke u bazuar në LVL. ZAMV-ja do të ekzistojë deri në themelimin e Komunës Mitrovica e Veriut apo deri sa Qeveria të vendos ndryshe. Pas zgjedhjeve komunale dhe themelimit të Komunës Mitrovica e Veriut, Kuvendi dhe komitete e përhershme do të konstituohen.

2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE

Respektimi dhe mbrojtja e minoriteteve dhe të drejtat kulturore

2.1. Sa zbatohet kurikula në gjuhën rome ?

Në pyetjen e parashtruar se sa zbatohet kurrikula në gjuhën rome, 13 Komuna janë përgjigjur se në komunat e tyre nuk ka nxënës të cilët janë të interesuar të vijnë arsimimin në gjuhën rome. Ndërsa, 10 komuna kanë komentuar se janë të integruar në shkollimin me etnitete të tjera, kurse në ZAMV dhe në Pejë ekzistojnë klasë të cilat e vazhdojnë mësimin në gjuhën rome. Ndërkaq, Komuna e Malishevës dhe Prizrenit kanë thënë se nuk kanë kurrikula. Ndërsa, komuna e Deçanit është përgjigjur se nuk ka të interesuar për të mësuar në gjuhën rome, por vetëm gjuhën shqipe. Komuna e Graçanicës është përgjigjur se gjuha rome përdoret vetëm në edukimin jo formal, ndërsa në shkolla nuk ka programe për gjuhën rome.

2.2. Numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën fillore ?

Në pyetjen e parashtruar se sa është numri i nxënësve të cilët e kanë braktisur shkollën në nivelin e ulët dhe atë të lartë. Prej tyre, 11 komuna janë përgjigjur se nuk kanë raste të tilla, 2 komuna nuk kanë dhënë përgjigje, kurse 15 komuna i kanë paraqitur detajet për numrin e nxënësve të cilët e kanë braktisur shkollimin. Komuna e Mitrovicës së Veriut ka thënë që numri është i vogël. Marrë në përgjithësi, numri i nxënësve të cilët e kanë braktisur shkollën fillore del të jetë 180 nxënës.

2.3. Numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën e mesme të ulët (obligative) ?

Në pyetjen e parashtruar se çfarë veprime ka ndërmarrë komuna juaj për të siguruar qasje në arsim dhe për të luftuar braktisjen e shkollimit, 14 komuna kanë thënë se kanë ndërmarrë veprime nëpër shkolla për parandalimin e mos shkollimit, 9 komuna nuk kanë ndërmarr asnjë veprim, ndërkaq 6 komuna nuk janë përgjigjur fare. Numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën e mesme të ulët (obligative) del të jetë 342 nxënës.

Numri i nxënësve të rikthyer në shkolla (pas braktisjes)?

Numri i nxënësve është gjithsej 99.

2.4. Numri i nxënësve që vijojnë mësimin?

Është 206 nxënës.

2.5. Nga shkollimi jo formal janë në mësim të rregullt?

Gjithsej janë 30 nxënës.

Kurse, në paraqitjen e informatave lidhur me numrin e vizitave që Qendra për Punë Sociale i ka bërë familjeve të komunitetit pakicë me qëllim të vlerësimit të mirëqenies së fëmijëve, 10 komuna kanë thënë se Qendra për Punë Sociale ka bërë vizita, 4 komuna nuk kanë bërë fare, 14 komuna nuk kanë dhënë përgjigje, kurse në ZAMV kjo punë iu është besuar një OJQ-je.

3. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR OBLIGIMET QË DALIN NGA MSA-ja

Drejtësia dhe çështjet e brendshme

Azili, migrimi, politika e vizave dhe kontrolli i kufijve

Në pyetjen e parashtruar se a ka përfunduar decentralizimi i fondit për riintegrim. 27 komuna janë përgjigjur se ky fond menaxhohet nga niveli qendror. Gjithashtu, Komunitetet kanë paraqitur shqetësimin e tyre se ka vonesa në zbatimin e kërkesave nga Ministria e Punëve të Brendshme. Komuna e Skenderajt nuk është përgjigjur në këtë pyetje, ndërsa Komuna e Shtërpcës ka thënë se kjo komunë e menaxhon pjesërisht këtë fond.

3.1. Numri i kërkesave të dorëzuara në komunë për fond të riintegrit (të ndara në bazë të natyrës së kërkesave: ushqim, strehim, ndihmë mjekësore, gjenerim të të hyrave, etj) ?

Në kërkesën e dërguar lidhur me paraqitjen e numrit të kërkesave nga të riatdhesuarit tek organet komunale, 27 komuna kanë dhënë informacionet në mënyrë të detajizuar me përjashtim të Komunës së Skenderajt dhe Hanit të Elezit të cilat nuk ka dhënë përgjigje në këtë pyetje.

2 komuna kanë raportuar se nuk ka pasur kërkesa nga personat e riatdhesuar për biznes plane në tre mujorin e parë të vitit 2013. Komunitat në fjalë janë: Komuna e Vitisë dhe Komuna e Mitrovicës së Veriut.

Komuna e Dragashit është përgjigjur se nuk ka pasur asnjë kërkesë gjatë këtij 3 mujori, kurse Komuna e Novobërdës ka thënë se nuk marrin vendime për biznes plane në komunë, ndërkohë Komuna e Deçanit nuk ka cekur numër të kërkesave për biznes plane, mirëpo ka thënë se bënë vetëm zbatimin e vendimeve.

Gjatë tre mujorit të parë janë bërë 115 kërkesa për plane të bizneseve nga personat e riatdhesuar. Janë mbajtur gjithsej 76 takime për shqyrtimin e kërkesave të personave të riatdhesuar, me përjashtim të 7 komunave të cilat nuk kanë raportuar për numrin e takimeve të mbajtura të KKR-ve.

Po ashtu, në kërkesën për paraqitjen e informacioneve lidhur me numrin e takimeve të mbajtura në komunë nga Komisioni Komunal për Riintegrim gjatë periudhës raportuese, numrin e takimeve të rregullta për riintegrim mes komunave dhe nivelit qendror dhe numrin e takimeve të rregullta të komunave me shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe atashetë e migracionit, prej tyre 17 komuna kanë thënë se i mbajnë në mënyrë të rregullt këto takime, 10 komuna nuk kanë dhënë përgjigje, ndërsa 2 komuna kanë raportuar që nuk mbajnë takime.

3.2. Bujqësia - Hartimi i politikave, planeve dhe programeve zhvillimore për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural

Në pyetjen e parashtruar se a është i hartuar Programi Zhvillimor në përputhje me Master Planin mbi Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë 2010-2013 dhe Strategjinë Komunale për Zhvillim. Prej tyre, 13 komuna kanë thënë se kanë strategji komunale e cila është në përputhje me Master Planin mbi Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë 2010 - 2013, 9 komuna kanë thënë se punojnë në bazë të Master Planit, si dhe 7 komuna nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.

Pyetja e radhës është se a ka sipërfaqe të tokës të konsoliduar, 16 komuna kanë thënë se e kanë të konsoliduar sipërfaqen e tokës, 12 komuna nuk kanë dhënë përgjigje, ndërkaq Komuna e Klinës ka thënë se është në proces e sipër të konsolidimit.

Në pyetjen se a është themeluar dhe a është funksional Grupi i Veprimit Lokal (GVL), 21 komuna kanë thënë se e kanë të formuar këtë grup, 7 komuna nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje, kurse Komuna e Kamenicës është përgjigjur se nuk e ka të themeluar GVL-në.

3.3. Çfarë mbështetje ofron komuna në modernizimin e sektorit privat të bujqësisë ?

Në pyetjen e paraqitur se sa është numri dhe vlera totale e granteve dhe subvencioneve të dhëna fermerëve. Prej tyre, 21 komuna kanë dhënë përgjigjet, si dhe kanë paraqitur të dhënat, një komunë është përgjigjur se nuk ka marrë grante, kurse 8 komuna nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.

3.4. Niveli i zbatimit të udhëzimeve (p.sh. cila pjesë e udhëzimit zbatohet në tërësi, cila pjesë nuk zbatohet fare, etj) ?

Komunat të cilat i zbatojnë në tërësi udhëzimet janë gjashtëmbëdhjetë (16) si: Podujeva, Obiliqi, Shtimja, Malisheva, Vushtrria, Mitrovica, Peja, Juniku, Shtërpca, Klina, Novobërda, Drenasi, F.Kosova, Lipjani, Hani i Elezit dhe Kaçaniku, ndërsa Komuna e Dragashit ka thënë se zbatohen vetëm ato udhëzime për cilat janë shënuar të drejtat dhe obligimet e komunës. Komunat të cilat nuk kanë dhënë përgjigje janë (11)si: Ferizaj, Gjakova, Mitrovica e Veriut, Istogu, Skenderaj, Vitia, Prishtina, Rahoveci, Deçani, Kamenica. Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Prizrenit kanë potencuar se dy udhëzime nuk janë zbatuar në vitin 2012: a)Udhëzimi për vlerësimin vjetor për shërbyesit civil dhe b)Udhëzimi për klasifikimin e vendeve të punës për shërbyesit civil.

3.5. Sasia apo vlera e teknologjisë së re të blerë nga këto grante / subvencione ?

Në këtë drejtim, 14 komuna kanë paraqitur sasinë apo vlerën e teknologjisë së re të blerë nga këto grante/subvencione, 4 komuna të tjera kanë thënë se nuk është blerë ndonjë teknologji e re me mjetet e këtyre granteve, kurse 11 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

Komunat të cilat kanë treguar se nuk kanë blerë asgjë nga këto grante/subvencione për teknologji janë: Podujeva, Istogu, Fushë Kosova dhe Hani i Elezit.

Komunat të cilat kanë treguar sasinë apo vlerën e teknologjisë së re të blerë nga grantet/subvencionet janë: Prizreni 47.000 euro, Vushtrria 103.404 euro dhe Lipjani 15.000 euro. Nga mjetet e shpenzuara, Komunat kanë blerë 57 makina mjelëse.

Në Komunën e Pejës janë dhënë 1100 grante për 2 projekte të ndryshme, në vitin 2011 në Komunën e Junikut, fermerëve u janë dhuruar 20 makina mjelëse për lopë qumështore nga një donacion i KFOR-it italian, kurse Komuna e Kamenicës ka potencuar se përmes zyrës janë këshilluar mbi 700 fermer me makina mjelëse. Ndërsa, Komunat të cilat nuk janë përgjigjur fare në pyetjen e parashtruar janë: Obiliqi, Ferizaj, Gjakova, Dragashi, Malisheva, Mitrovica, Mitrovica Veriore, Skenderaj, Shtërpca, Klina, Novobërda, Vitia, Drenasi, Prishtina, Rahoveci, Deçani, Kaçaniku dhe Graçanica.

3.6. Numri dhe vlera totale e granteve dhe subvencioneve të dhëna fermerëve ?


Komunat të cilat kanë dhënë përgjigje për numrin dhe vlerën totale të granteve dhe subvencioneve të dhëna fermerëve janë: Podujeva 50.000 euro, Prizreni 95.000 euro, Vushtrria 556.898.27 euro, Istogu 60.000 euro, Fushë Kosova 375.000 euro(ka cekur se janë planifikuar vetëm për vitin 2013), Novobërda 21.000 euro, Vitia 10.000, Drenasi në bashkëpunim me MBPZHR 726.347euro, Deçani 341.494.000 euro, Kaçaniku 46.300.000 euro, Kamenica 30.000 euro (janë planifikuar vetëm për vitin 2013) Graçanica 133.000.891 euro. Ndërkaq, komunat të cilat kanë dhënë lloje të ndryshme të subvencioneve dhe granteve janë: Obiliqi, Gjakova, Malisheva, Peja dhe Klina. Kurse, Komunat të cilat nuk kanë dhënë fare përgjigjeje janë: Mitrovica, Mitrovica Veriore, Shtërpca, Prishtina dhe Rahoveci. Komuna e Ferizajt ka thënë se janë në përpunim, Komuna e Shtimes ka theksuar se nuk është i qartë numri dhe vlera e tyre, Komuna e Dragashit ka thënë se nuk ka dhënë subvencione. Gjithashtu edhe Komuna e Junikut nuk ka dhënë subvencione, vetëm disa nga ana e MBPZHR. Komuna e Skenderajt ka thënë se nuk kemi fonde të mjaftuara, ndërsa Komuna e Lipjanit ka dhënë vetëm një subvencion për vitin 2012.

3.7. Vlera e granteve / subvencioneve të investuara në marketing ?

Lidhur me vlerën e granteve/subvencioneve të investuar në marketing, prej tyre 6 komuna i kanë paraqitur detajet për këtë fushë, 8 komuna kanë thënë se nuk kanë investuar në marketing, ndërkaq 7 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

Komunat të cilat kanë investuar në marketing dhe kanë treguar vlerën e shumës që kanë investuar janë: Podujeva 300 euro, Istogu 3.500 euro, Deçani 87.50 euro dhe Shtime ka realizuar një proces marketing përmes MBPZHR. Komunat të cilat nuk kanë

investuar fare janë: Gjakova, Dragashi, Vushtrria, Peja, Juniku, Skenderaj, Klina dhe F. Kosova. Komunat të cilat nuk janë përgjegjur janë: Obiliqi, Ferizaj, Prizreni, Malisheva, Mitrovica, Mitrovica Veriore, Shtërpca, Prishtina, Novobërda, Vitia, Drenasi, Lipjani, Rahoveci, H. Elezit, Kaçaniku, Kamenica dhe Graçanica.



Tab.5. Numri i granteve në komuna

3.8. Niveli i përmirësimit të efikasitetit të ndërmarrjeve agro-përpunuese?

Në pyetjen e parashtruar se sa është niveli i përmirësimit të efikasitetit të ndërmarrjeve agro-përpunuese në komuna, prej tyre 14 komuna janë përgjegjur që ka nivel të përmirësimit të efikasitetit të ndërmarrjeve agro përpunuese, 7 nga Komunat kanë thënë se nuk kanë ndonjë përmirësim, kurse 8 prej komunave nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.

Komunat në të cilat niveli i përmirësimit të efikasitetit të ndërmarrjeve agro-përpunuese është i kënaqshëm janë: Podujeva, Gjakova, Dragashi, Malisheva, Vushtrria, Istogu, Peja, Skenderaj dhe Drenasi, kurse Komunat që nuk kanë ofruar përgjigje janë: Obiliqi, Prizreni, Mitrovica, Mitrovica Veriore, Klina, Novobërda, Lipjani, Rahoveci, Hani i Elezit, Kaçaniku, Kamenica dhe Graçanica.

Komunat si: Juniku, Vitia dhe Fushë Kosova nuk kanë ndërmarrje agro-përpunuese, kurse në Komunën e Ferizajt dhe Shtimes ndërmarrjet agro-përpunuese janë në proces e sipër të ndërtimit, ndërkaq në Komunën e Prishtinës është në kapacitet të nivelit qendror përkatësisht të MBPZHR.

4. PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS NË ZONAT RURALE

22 komuna janë përgjegjur se kanë investuar në përmirësimin e infrastrukturës në zonat rurale si: rrugë, rrjet elektrik, furnizim me ujë dhe transport. 6 komuna nuk kanë dhënë përgjigje, kurse Komuna e Junikut ka thënë se nuk ka bërë ende ndonjë investim në infrastrukturë.

19 komuna janë përgjegjur për aktivitetet e zhvilluara duke theksuar se sistemi i ujitjes është rehabilituar, 6 komuna nuk kanë dhënë përgjigje, ndërkaq 4 komuna kanë thënë se nuk kanë investuar.

Në veprimin për paraqitjen e informacioneve për llojin e projekteve të realizuara në zonat rurale përmes Grupeve Lokale të Veprimit (GLV) me ndikim në zonat rurale, 14 komuna i kanë paraqitur informacionet e kërkuara, 1 komunë nuk ka paraqitur fare informacionet, kurse 14 komuna nuk kanë dhënë kurrfarë përgjigje.

5. SHFRYTËZIMI DHE MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I PYJEVE

5.1. Çfarë ka ndërmarrë komuna juaj në mbrojtjen e pyjeve ?

Në lidhje me sipërfaqet e pyllëzuara në ha, 16 komuna i kanë paraqitur detajet, 5 komuna kanë thënë që nuk kanë bërë pyllëzim, 8 komuna nuk kanë dhënë përgjigje, ndërsa 1 komunë është përgjegjur se për vitin 2013 nuk ka zhvilluar ndonjë aktivitet.

23 komuna i kanë paraqitur informacionet e kërkuara për numrin e fletëparaqitjeve të ushtruara, numrin e inspektimeve, numrin e dënimeve për kundërvajtje, veprat penale për dëmtuesit dhe shfrytëzuesit ilegal të pyjeve. 6 komuna nuk kanë dhënë asnjë përgjigje.

Numri i të dhënave është si në vijim:

- 1) Numri i inspektimeve është 485;
- 2) Numri i dënimeve të shkaktuara është 943;
- 3) Numri i fletëparaqitjeve të ushtruara është 2528;

- 4) Numri i dëmeve të shkaktuara është 1196ha;
- 5) Numri i kundërvajtjeve është 845;
- 6) Numri i veprave penale është 136;
- 7) Sipërfaqe e pyllëzuar është 235ha;

16 komuna i kanë paraqitur informacionet për nivelin e dëmeve të shkaktuara nga prerjet ilegale dhe nga zjarret, 4 nga komunat kanë thënë se nuk kanë pasur dëme, kurse 9 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

17 komuna kanë thënë se i kanë themeluar Qendrat për Këshilla Rurale (duke dhënë Këshilla për Biznese), 8 komuna kanë thënë se nuk e kanë të themeluar këtë qendër, ndërsa 4 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

21 komuna kanë thënë se kanë dhënë në mënyrë të vazhdueshme këshillime profesionale për fermerët, 7 komuna nuk japin këshilla, kurse Komuna e Rahovecit nuk është përgjigjur.

21 komuna kanë thënë se organizojnë fushata të vetëdijesimit për qytetarët lidhur me rëndësinë e bujqësisë, shërbimet këshillimore për fermerë dhe OJQ-të, në 7 komuna nuk ka organizim të fushatave për vetëdijesimin e qytetarëve, kurse Komuna e Rahovecit nuk është përgjigjur.

6. KONTROLI FINANCIAR

6.1. Zhvillimi i Auditimit të Brendshëm, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) në sektorin publik në harmoni me standardet dhe praktikat ndërkombëtare

Njësia Komunale për Auditim të Brendshëm është e themeluar në 25 komuna, përveç Komunës së Shtërpcës e cila nuk ka dhënë përgjigje, ndërsa Komuna e Klinës, Obiliqit, dhe Hanit të Elezit kanë thënë se ende nuk e kanë të themeluar Njësine Komunale për Auditim të Brendshëm.

Kurse, sa i përket Komitetit për Auditim të Brendshëm, 16 komuna kanë thënë se e kanë të themeluar Komitetin për Auditim të Brendshëm, ndërkaq Komuna e Istogut, Lipjanit dhe Hanit të Elezit ende nuk e kanë të themeluar Komitetin, kurse Komuna e Deçanit, Gjakovës dhe Klinës janë në proces të themelimit. Komuna e Vitisë është përgjigjur se Komiteti për Auditim të Brendshëm është i themeluar mirëpo nuk funksionon, ndërsa 6 komuna të tjera nuk kanë dhënë përgjigje.

Gjatë periudhës raportuese, 17 komuna e kanë paraqitur numrin e takimeve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, 5 komuna nuk e kanë paraqitur, ndërsa 7 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

Lidhur me numrin e auditorëve të brendshëm, 25 komuna e kanë paraqitur numrin e tyre, kurse 4 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

Për periudhën tremujore, Komuna e Mitrovicës së Veriut, Junikut, Skenderajt dhe Hanit të Elezit nuk posedojnë rekomandim nga ky shërbim, ngase auditori ende është në zhvillim e sipër të procesit të certifikimit.

17 komuna janë deklaruar se kanë marr rekomandimet e Auditorit të Brendshëm, 8 komuna nuk kanë dhënë përgjigje, kurse 3 komuna kanë thënë se nuk i kanë marrë ende rekomandimet.

13 komuna i kanë paraqitur informacionet për zbatueshmërinë apo jo të rekomandimeve, ndërkaq 16 komuna nuk kanë dhënë përgjigje për këtë veprim.

15 komuna kanë thënë se bëjnë dhe e kanë dorëzuar në MFK, 3 komuna kanë thënë se nuk i kanë dorëzuar, kurse 11 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

Punësimi, politika sociale dhe politika e shëndetit publik - Adoptimi i politikave të përfshirjes sociale dhe anti-diskriminuese si dhe masave për përmirësimin e situatës së grupeve të cenuara

6.2. Çfarë masa ka ndërmarrë komuna juaj për përmirësimin e situatës socio-ekonomike të grupeve të cenuara (komunitet pakicë, personat me aftësi të kufizuar, viktimat e dhunës në familje, etj) ?

Strategjia komunale ka të integruar politikat e punësimit dhe atyre sociale në 13 komuna, ndërsa 16 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

20 komuna kanë paraqitur numrin e vizitave të QPS-së, 2 komuna kanë theksuar se nuk kanë pasur vizitë, si dhe 7 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

24 komuna i kanë paraqitur numrin e personave/familjeve të identifikuar që kanë nevojë për kujdes social, kurse 5 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

23 komuna i kanë paraqitur informacionet për ndihmën e ofruar grupeve të cenuara, 3 komuna kanë thënë se nuk i kanë dhënë këto ndihma, ndërkaq 3 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

17 komuna kanë thënë se Komuna ka përfshirë OJQ-të në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale, 4 komuna nuk i kanë përfshirë OJQ-të, kurse 8 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjitha komunitetet minoritare, me prioritet komunitetin romë, ashkali dhe egjiptas, si dhe kryerja e veprimeve për përmirësimin e regjistrimit, zvogëlimin e kontaminimit me plumb dhe rritjen e shkallës së vaksinimit në mesin e bashkësisë RAE, ngritjen e kapaciteteve të Njësisë për Metale të Rënda brenda MSH-së.

6.3. Në çfarë forme komuna juaj ofron shërbime shëndetësore për komunitetet pakicë?

Plani i veprimit komunal është miratuar dhe në kuadër të saj përfshihen komunitetet pakicë duke i kushtuar rëndësi të veçantë komunitetit RAE. Prej tyre, 17 komuna nuk kanë dhënë përgjigje lidhur me këtë fushë, 6 komuna kanë thënë se e kanë planin e veprimit komunal, kurse 6 komuna kanë thënë se janë në hartim e sipër të këtij plani.

Komunitetet pakicë kanë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore. Për këtë veprim, 27 komuna kanë thënë se kanë qasje të barabartë, Komuna e Junikut ka thënë se është etnikisht e pastër, ndërkaq Komuna e Rahovecit nuk ka dhënë përgjigje për shërbimet shëndetësore për komunitetet.

Komuna e Podujevës, Hanit të Elezit, Deçanit, Kaçanikut, Kamenicës, Graçanicës, Gjakovës, Prizrenit, Shtimes, Ferizajt, Drenasit, Fushë Kosovës, Prishtinës, Lipjanit, Malishevës, Mitrovicës, Vushtrrisë, Istogut, Pejës, Skenderajt, Shtërpçës, Klinës dhe Novobërdës kanë thënë se komuniteti RAE ka qasje të barabartë sikurse të gjithë qytetarët tjerë dhe pacientët kanë një privilegj në këto shërbime si: vizitat, ndihma me medikamente, analiza laboratorike, marrja e terapisë sipas listës esenciale, bërja e imazheve rëntgenologjike, shërbimet stomatologjike, parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin që ka të bëjë me sëmundjet, rregullimet dhe lëndimet, edukimin shëndetësor, imunizimin dhe vaksinimin etj.

Për veprimin fushatë informative për komunitetet pakicë rreth shëndetit familjar, parandalimin e infektimit dhe vaksinimit, 16 komuna kanë thënë se kanë mbajtur fushata, 2 komuna kanë deklaruar se nuk kanë mbajtur fushata, ndërkaq 11 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

23 komuna kanë thënë se kanë qasje pro-aktive në vaksinim, 1 komunë ka thënë se nuk ka komunitete, kurse 5 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

7. MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në sektorin e mjedisit në nivelin qendror dhe lokal.

7.1. Sa janë ngritur kapacitetet në komunën tuaj në sektorin e mjedisit ?

Për veprimet e ndërmarra mund të përmendim:

- 1) Numrin e trajnimeve për zyrtarët komunal për zbatimin e legjislacionit mjedisor;
- 2) Numrin e trajnimeve të mbajtura me inspektor komunal të ambientit;
- 3) Numrin e trajnimeve për zyrtarët komunal në trajtimin e vendbanimeve joformale;
- 4) Numrin e trajnimeve për zyrtarët komunal për procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Urbane;
- 5) Numrin e trajnimeve për planerët urban komunal për interpretimin e Ligjit të ri për Planifikim Hapësinor;
- 6) Numri i Inspektoreve Komunal të Ambientit;
- 7) Vendbanimet jo formale të përfshira në planet hapësinore komunale;

Prej tyre, 26 komuna i kanë dhënë informacionet për trajnimet e mbajtura, 1 komunë nuk ka dhënë përgjigje, kurse 2 komuna kanë thënë se nuk kanë mbajtur trajnime të këtij lloji.

Të thellohet bashkëpunimi mes institucioneve që kanë ndikim dhe përgjegjësi në sektorin e mjedisit

7.2. Çfarë bashkëpunimi ka ndërmjet ministrive dhe komunës në sektorin e mjedisit?

Në këtë veprim, 21 komuna kanë thënë se kanë pasur bashkëpunim me nivelin qendror, 7 komuna nuk kanë dhënë përgjigje, ndërkaq gjatë kësaj periudhe raportuese (pra për 3 mujorin e parë) Komuna e Istogut kanë thënë se nuk ka pasur bashkëpunim me nivelin qendror në sektorin e mjedisit.

Zbatimi i politikave mjedisore me qëllim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit

7.3. Sa janë zbatuar politikat mjedisore për përmirësimin e gjendjes së mjedisit ?

Në çështjen e zbatimit të politikave mjedisore me qëllim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit, 12 komuna kanë thënë se kanë punuar në krijimin e sipërfaqeve të reja gjelbëruese, ku prej tyre vetëm Komuna e Gjakovës dhe Lipjanit kanë paraqitur në mënyrë të detajuar hapësirat e gjelbëruara e para në hapësirë prej 5000m², përkatësisht e dyta në hapësirë prej 26660.00m² sipërfaqe të parqeve dhe shesheve. Ndërsa, komunat e tjera kanë dhënë përgjigje të përgjithshme si p.sh. është zhvilluar një aktivitet për shpalljen e disa zonave të mbrojtës së natyrës, janë krijuar disa miniparqe, pritjet të rritet shiriti i gjelbër në qytet, është ndërtuar Parku gjelbërues në Mirushë nga Komisioni Evropian për zhvillim, është bërë gjelbërimi në një sipërfaqe të mjaftueshme në pjesët kryesore të qytetit si dhe breg rrugëve. Ndërkaq, 3 komuna kanë thënë se nuk i kanë zbatuar politikat mjedisore për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, kurse 14 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

Lidhur me nivelin e zbatimit të planit lokal të veprimit në mjedis, 7 komuna e kanë paraqitur mirë nivelin e zbatimit, si: Komuna e Podujevës, Obiliqit, Gjakovës, Dragashit, Junikut, Hanit të Elezit, kurse Komuna e Ferizajt ka thënë se është duke punuar gradualisht. Ndërkaq, 9 komuna të cilat ende nuk e kanë këtë plan janë: Prizreni, Vushtrria, Shtërpca, Vitia, Drenasi, Fushë Kosova, Lipjani, Rahoveci dhe Kaçaniku, kurse 13 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

Komuna e Shtimes është duke e zbatuar Planin Lokal të Mjedisit përmes OJQ-ve, "FIQ" dhe komunën. Faza e parë e zbatimit të PLVM-së nga Komuna e Istogut dhe Komuna e Junikut është e kënaqshme.

Sa i përket Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave dhe nivelit të zbatimit të saj, 14 komuna kanë thënë se e kanë hartuar këtë plan dhe niveli i zbatimit është i mirë. Në këtë drejtim hyjnë Komuna e Ferizajt e cila është duke e zbatuar gradualisht planin, Komuna e Shtimes e zbaton planin përmes kompanisë "Pastërtia", Komuna e Dragashit mbeturinat i menaxhon përmes ndërmarrjes publike, në Komunën e Malishevës mbeturinat menaxhohen nga "Eko-Regjioni" përmes njësitit Lumi, Gjithashtu, zbatues të planit janë edhe Komuna e Mitrovicës, Komuna e Prishtinës, Komuna e Istogut, Komuna e Hanit të Elezit, Komuna e Klinës, Komuna e Fushë Kosovës ka thënë se plani zbatohet sipas ligjit për VSM, Komuna e Vushtrrisë ka plan dhe niveli i zbatimit të tij është i kënaqshëm, Komuna e Shtërpcës ka thënë se planet për menaxhimin e mbeturinave janë paraparë me PZHK, kurse Komuna e Kamenicës ka thënë se ekziston plani, mirëpo duhet të plotësohet.

10 komuna kanë thënë se nuk e kanë një plan të tillë, ndërsa 5 komuna nuk kanë dhënë fare përgjigje.

Lidhur me publikimin e raportit për gjendjen e mbeturinave, 11 komuna kanë thënë se e kanë publikuar këtë raport, si: Drenasi, Juniku, Peja, Istogu, Vushtrria, Mitrovica, Malisheva, Dragashi, Gjakova, Obiliqi dhe Podujeva. Ndërsa, 6 komuna ende nuk e kanë publikuar, kurse 12 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

Në fushën e studimit të arsyeshmërisë për shpalljen e zonës së mbrojtur në komuna, një gjë të tillë e kanë kryer 7 komuna, 2 komuna nuk e kanë bërë fare këtë studim, si dhe 20 komuna nuk kanë dhënë përgjigje.

3 komuna kanë thënë se kanë gurëthyes, mirëpo nuk ndikojnë në ndotjen e ambientit, ndërsa 9 komuna kanë thënë se kanë gurëthyes dhe kanë ndikim mjaftë të lart në ndotjen e ambientit. 11 komuna nuk janë përgjigjur kësaj pyetje, ndërkaq 6 komuna kanë treguar vetëm numrin e gurëthyesve që i posedojnë, mirëpo nuk kanë treguar se sa ndikojnë në ndotjen e ambientit.

14 komuna kanë thënë se vlerësimi i ndikimit në mjedis zbatohet sipas dispozitave ligjore, 11 komuna nuk kanë dhënë përgjigje. Komuna e Drenasit ka thënë se vlerësimin e bënë MMPH dhe KPMM. Komuna e Klinës ka thënë se ndikimi i tyre në mjedis është jashtë standardeve ligjore, Komuna e Prizrenit ka thënë se është në kompetencë të MMPH-së, si dhe Komuna e Malishevës ka thënë se bëhet vlerësimi mirëpo nuk ndërmerret asgjë.